



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

RAPORTI VJETOR

2021

Prishtinë, 2022

RAPORTI VJETOR 2021

Përmbajtja

Përmbajtja.....	5
FJALA HYRËSE E KRYETARES SË GJYKATËS KUSHTETUESE	7
RAPORT VJETOR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR VITIN 2021.....	10
SEKRETARIATI I GJYKATËS KUSHTETUESE	12
NJËSIA LIGJORE.....	15
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE.....	19
DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE, STATISTIKËS DHE ARKIVIT	31
DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE.....	43
DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCEVE	47
NJËSIA E PROKURIMIT	55
NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT KOMUNIKIMIT DHE MULTIMEDIEVE	59
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM	63
ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM	67
AKTIVITETET TJERA TË GJYKATËS KUSHTETUESE	71
SHTOJCA I	77
ORGANOGRAMI	81

FJALA HYRËSE E KRYETARES SË GJYKATËS KUSHTETUESE

Pavarësisht se ka vetëm pak më shumë se një dekadë që nga funksionalizimi i saj, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është një institucion jashtëzakonisht i konsoliduar bazuar në vlerat dhe parimet demokratike e të sundimit të ligjit, me një jurisprudencë të pasur, posaçërisht në fushën e kërkesave individuale, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për pasojë, një gardian efektiv i të drejtave e lirive themelore për të gjithë qytetarët.

Raporti vjetor për vitin 2021, shpërfaq vetëm punën e Gjykatës Kushtetuese përgjatë vitit të fundit, rezultatet e së cilës, sigurisht burojnë edhe nga të arriturat e viteve paraprake si në kuptim të zhvillimit të praktikës gjyqësore po ashtu edhe në kuptim të zhvillimit institucional. Sigurisht që përgjatë vitit të kaluar, shfaqja e pandemisë Covid-19, vështirësoi edhe funksionalitetin e institucioneve shtetërore. Megjithatë, sfidat që rezultuan nga pandemia, hapën edhe horizonte të reja, përkatësisht ngritjen e mekanizmave të komunikimit efektiv virtual në mënyrë që të mbahet ritmi institucional dhe të mos pengohet arritja e rezultateve të planifikuara. Prandaj, edhe përkundër efekteve të pandemisë, kufizimeve të imponuara dhe domosdoshmërisë së adaptimit në rrethanat e reja të punës, për më tepër edhe përbërjes së Gjykatës me vetëm shtatë gjyqtarë për gjysmën e fundit të vitit, Gjykata Kushtetuese ka përmbyllur me sukses objektivat dhe aktivitetet e planifikuara në planin vjetor të punës dhe të cilat janë prezantuar në detaje në këtë raport vjetor.

Raporti vjetor, në vazhden e praktikës së konsoliduar të kësaj Gjykate, ka për qëllim transparencën e plotë me publikun përkitazi me të gjithë aktivitetet e saj përgjatë vitit raportues. I njëjti pasqyron në mënyrë të përmbyllur të gjitha informacionet relevante lidhur me punën e Gjykatës dhe secilit departament të saj, përfshirë statistikën e nevojshme lidhur me kërkesat e pranuar dhe të zgjidhura, tipologjinë e shkeljeve kushtetuese të pretenduara para Gjykatës, aktivitetet administrative, vizitat zyrtare dhe punëtoritë e mbajtura, si dhe informata të detajuara përkitazi me menaxhimin e financave publike.

Fillimisht dhe për sa i përket lëndëve, Gjykata vitin e kaluar ka pranuar gjithsej 235 kërkesa, ndërsa 186 sosh janë bartur nga vitet paraprake. Nga numri total i kërkesave të pranuar, 203 prej tyre janë parashtruar nga individët, përderisa 32 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet publike. Ndërkaq, në ueb-faqen e Gjykatës janë publikuar 245 vendime, prej të cilave 32 Aktgjykime dhe 176 Aktvendime për papranueshmëri. Numri, në rritje të vazhdueshme, i kërkesave të parashtruara në krahasim me vitet paraprake dhe ndërlikueshmëria e çështjeve të trajtuara, janë gjithashtu indikator i besimit në rritje të qytetarëve në punën dhe vendimmarrjen e Gjykatës.

Në këtë aspekt, dëshiroj të përmend disa nga rastet më të rëndësishme të vendosura gjatë vitit 2021 e që: (i) ndërlidhen me funksionimin e institucioneve bazuar në parimet e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe sundimit të ligjit; dhe (ii) interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara në Kushtetutë dhe instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare.

Në kontekst të së parës, përkatësisht kontrollit abstrakt, Gjykata përgjatë vitit 2021 ka publikuar një numër Aktgjykimesh, duke përfshirë vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të Kuvendit përkitazi me zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. I pari, përkatësisht Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KO95/20, vlerësoi kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të 3 qershorit 2020 për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës, duke konstatuar jokushtetutshmërinë e të njëjtit, sepse për shkak të dënimit me vendim të formës së prerë për vepër penale, mandati i njërit nga deputetët që kishte votuar për Qeverinë, vota e të cilit ishte përcaktuese për zgjedhjen e Qeverisë, ishte i pavlefshëm dhe rrjedhimisht, Qeveria nuk mund të ishte konsideruar e zgjedhur me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit siç

përcaktohet në nenin 95 të Kushtetutës. Për pasojë, dhe bazuar në këtë të fundit, Presidentja e Republikës shpalli zgjedhjet e jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës. Ndërsa, i dyti, përkatësisht Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KO61/21, kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të 22 marsit 2021 për zgjedhjen e Qeverisë, duke konstatuar kësaj radhe kushtetutshmërinë e të njëjtit, sepse përkundër pretendimeve të parashtruesve përkatës, Gjykata kishte sqaruar që në rastet kur Qeveria duhet të ketë një ministër të tretë nga komunitetet joshumicë për shkak se në përbërjen e saj ka më shumë se dymbëdhjetë ministra, në rast se kandidati i propozuar është nga radhët e deputetëve të Kuvendit, zgjedhja e tij/saj jodetyrimsht kërkon miratimin formal të shumicës së deputetëve por vetëm konsultimin me partitë, koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetin joshumicë në fjalë.

Për më tepër, përgjatë vitit të kaluar, Gjykata gjithashtu vlerësoi kushtetutshmërinë e vendimeve të tjera të Kuvendit, të cilat sipas pretendimeve të parashtruesve përkatës, kanë cenuar pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe/ose kanë rezultuar në diskriminim të qytetarëve të Republikës. Pretendimet për cenimin e pavarësisë së institucioneve të pavarura kushtetuese, Gjykata i shqyrtoi në rastin KO127/21, përmes së cilit konstatoi jokushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit për shkarkimin kolektiv të pesë anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, duke sqaruar se anëtarët e këtij Këshilli gëzojnë pavarësi kushtetuese dhe nuk mund të shkarkohen përkritazi me vendimmarrjen e tyre, dhe se me nxjerrjen e një vendimi pa shtjellimin e asnjë fakti të bazuar në ligjin e aplikueshëm, Kuvendi kishte tejkaluar kufijtë e kompetencës së mbikëqyrjes së punës së institucioneve publike në cenim të garancive kushtetuese përkritazi me pavarësinë e Këshillit në ushtrimin e funksionit të tij. Ndërsa, pretendimet për cenim të së drejtës për barazi para ligjit, përkatësisht diskriminim të qytetarëve të Republikës, Gjykata i shqyrtoi në rastin e Gjykatës KO93/21, përmes së cilit konstatoi kushtetutshmërinë e një akti të Kuvendit i cili kishte autorizuar pagesën e energjisë elektrike vetëm për qytetarët e Republikës në katër komuna të Republikës për një periudhë gjashtë mujore, brenda të cilës gjithashtu kishte detyruar Qeverinë që të adresojë çështjet që ndërlidhen me faturimin e energjisë elektrike në katër komunat përkatëse. Gjykata, përkundër faktit që kishte konstatuar që në rrethanat e rastit konkret, qytetarët që jetojnë dhe që nuk jetojnë në këto katër komuna, ishin në situata analoge dhe/ose relativisht të ngjashme, dhe për pasojë, kishte dallim në trajtim në mes këtyre dy kategorive qytetarësh, ky dallim, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk kishte rezultuar në diskriminim, sepse dallimi në trajtim: (i) ishte i përcaktuar në ligj; (ii) kishte një qëllim legjitim, përkatësisht dhe ndër tjerash, ruajtjen e sovranitetit energjetik të Republikës; dhe (iii) marrë parasysh natyrën e përkohshme të tij, ishte gjithashtu proporcional.

Në kontekst të së dytës, përkatësisht kontrollit individual, Gjykata përgjatë vitit 2021, ka publikuar një numër Aktgjykimesh, përmes të cilave ka konsoliduar më tej praktikën e saj gjyqësore përkritazi me të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, me theks në: (i) të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor; (ii) të drejtën për seancë dëgjimore dhe kushtet kur mungesa e një seance të tillë rezulton në shkelje të të drejtave kushtetuese; (iii) të drejtën për qasje në gjykatë; (iv) barazinë e armëve në procedura civile dhe penale; (v) parimin e sigurisë juridike; dhe (vi) mungesën e konsistencës, përkatësisht divergjencën e praktikës gjyqësore. Për më tepër, Gjykata ka zhvilluar më tej praktikën e saj gjyqësore, ndër tjerash, edhe në kuptim të: (i) të drejtave për jetë private; dhe (ii) të drejtave zgjedhore. Përkritazi me të drejtat për jetë private, Gjykata ka konsoliduar më tej praktikën e saj gjyqësore duke u bazuar në atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndër tjerash, në shqyrtimin e një rasti që ndërlidhej me të drejtat e nënës biologjike në raport me fëmijën e dhënë në adoptim dhe familjes përkatëse adoptuese. Ndërsa, përkritazi me të drejtat zgjedhore, përmes dy rasteve, Gjykata vlerësoi kushtetutshmërinë e dy vendimeve të Gjykatës Supreme, duke i shpallur të njëjtat kundër-kushtetuese. Duke aplikuar garancitë e përcaktuara përmes nenit 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata, ndër tjerash, sqaroi procedurën e pranimit të votave nga jashtë dhe afatet brenda të cilave të njëjtat mund të konsiderohen të vlefshme bazuar në ligjet e aplikueshme, duke sqaruar për më tepër

kufizimet e gjykatave të rregullta në shpalljen jokushtetuese të dispozitave ligjore dhe të drejtën kushtetuese të tyre për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese përmes kontrollit incidental në rast të dyshimeve për jokushtetutshmërinë e një norme. Ndërsa, duke aplikuar të njëjtat garanci, në rastin tjetër, Gjykata, ndër tjerash, trajtoi të drejtat zgjedhore dhe diskriminimin në bazë të gjinisë, duke sqaruar mënyrën e interpretimit të kuotës prej 30 % të përfaqësimit të grave në Kuvendin e Republikës, duke iu dhënë për pasojë të drejtë parashtrueseve përkatëse.

Duhet të theksohet që të gjitha vendimet e Gjykatës, përfshirë përmbledhjet dhe njoftimet përkatëse për publikun, janë të publikuara në ueb-faqen e Gjykatës në dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në gjuhën angleze. Gjithashtu, të gjitha Aktgjykimet dhe Aktvendimet më të rëndësishme, janë të përmbledhura dhe publikuara përmes Buletinit të Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese i cili është gjithashtu i qasshëm përmes ueb-faqes së Gjykatës.

Në anën tjetër, krahas punës së bërë në shqyrtimin e lëndëve dhe nxjerrjen e vendimeve përkatëse përgjatë vitit raportues, Gjykata ka ndërmarrë dhe zbatuar një varg aktiviteteve të dizajnuara për të avancuar më tej kualitetin dhe efikasitetin e funksionimit të saj të brendshëm dhe përforcimin e mekanizmave për transparencë të avancuar dhe komunikim efektiv me publikun. Përgjatë vitit, bazuar në diskutimin e identifikimin e sfidave dhe mundësive, aktiviteteve të saktësuara në Planin Strategjik për periudhën pesëvjeçare (2021–2025), por edhe analizave të shumta krahasimore, Gjykata, ndër tjerash: (i) i është nënshtruar dhe ka organizuar trajnime dhe diskutime tematike, edhe me mbështetjen e partnerëve të Gjykatës por edhe në bashkëpunim me gjykatat simotra, në fusha të ndryshme të kontrollit konkret, preventiv, abstrakt e incidental; (ii) ka avancuar më tej mekanizmat që sigurojnë kualitetin e hulumtimeve dhe analizave në kuadër të Njësisë Ligjore; (iii) ka ndërmarrë një numër ndryshimesh strukturore me qëllim të ngritjes së efikasitetit të funksionimit organizativ; (iv) ka amendamentuar/hartuar rregullore të brendshme që ndërlidhen edhe me menaxhimin efektiv të rasteve, por edhe kualitetin e punës së departamenteve dhe menaxhimit të financave publike; (v) ka avancuar më tej sistemet e teknologjisë informative; (vi) ka avancuar mekanizmat e komunikimit me publikun përkthazi me vendimmarrjen e saj; si dhe (vii) përmes aktiviteteve të ndryshme, përfshirë edhe vizitat protokollare, ka përforcuar më tej bashkëpunimin me gjykatat simotra, gjykatat ndërkombëtare dhe institucionet e tjera relevante.

Sigurisht që të arriturat e Gjykatës përgjatë vitit të kaluar janë fillimisht rezultat i punës së palodhshme të gjyqtarëve të saj, por edhe Këshilltarëve Kushtetues Juridik, Sekretarit të Përgjithshëm dhe të gjithë stafit të Gjykatës, përkushtimi i të cilëve kontribuon në mënyrë të vazhdueshme në jetësimin e plotë të mandatit kushtetues të Gjykatës Kushtetuese në harmoni me standardet më të mira ndërkombëtare. Për më tepër, falënderimet u dedikohen edhe partnerëve të vazhdueshëm të Gjykatës, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në Këshillin e Evropës, Ambasadën Norvegjeze, Ambasadën Franceze, Agjencionin Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar dhe IRZ-në Gjermane.

Për vitin vijues, Gjykata mbetet thellësisht e përkushtuar që përmes vendimmarrjes në rastet para saj, por edhe përmes aktiviteteve të cilat në mënyrë të vazhdueshme e avancojnë më tej kualitetin, efikasitetin, llogaridhënien dhe transparencën, të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës, si autoriteti përfundimtar në Republikë për interpretimin e Kushtetutës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë qytetarët e saj.

Gresa Caka-Nimani



Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

RAPORT VJETOR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR VITIN 2021

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata apo Gjykata Kushtetuese) është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, si dhe, bazuar në Kushtetutë, është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Në vitin 2021, Gjykata Kushtetuese pranoi 235 kërkesa të reja, nga të cilat Gjykata vendosi për 206 kërkesa. Ndërsa, duke përfshirë edhe lëndët të cilat janë bartur nga vitet e kaluara dhe janë vendosur në vitin 2021, Gjykata publikoi në ueb-faqen e saj dhe ua dorëzoi palëve 245 vendime.


Të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese u publikuan në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me paragrafin 2 të nenit 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe në pajtim me paragrafin 3 (i) të rregullit 16 (Seancat administrative) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës e Gjykatës), Gjykata Kushtetuese aprovoi raportin e saj vjetor për vitin 2021 në seancën administrative të mbajtur më 22 dhe 23 mars 2022.

Në pajtim me paragrafin 2 të nenit 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 18 (Sekretariati) të Rregullores së punës së Gjykatës, Sekretariati gjatë vitit 2021 organizoi mbarëvajtjen e pesë (5) seancave administrative. Në këto seanca administrative u morën njëzet e gjashtë (26) vendime.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2021, ishte e përbërë nga:


Arta Rama-Hajrizi, kryetare (deri më 25 qershor 2021);
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare, kryetare (nga 26 qershori 2021);
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar;
Bekim Sejdiu, gjyqtar (deri më 25 maj 2021);
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare;
Safet Hoxha, gjyqtar;
Radomir Laban, gjyqtar;
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare;
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.



Gresa Caka-Nimani
kryetare



Bajram Ljatifi
zëvendëskryetar




**Selvete Gërxhaliu-
Krasniqi**
gjqtare



Safet Hoxha
gjqtar



Remzije Istrefi-Peci
gjqtare



Radomir Laban
gjqtar



Nexhmi Rexhepi
gjqtar

SEKRETARIATI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 12 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Gjykatën Kushtetuese) dhe në pajtim me rregullin 18 të Rregullores së punës së Gjykatës, ka kryer punët administrative dhe ka mbështetur punën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Sekretariati udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm i cili, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e Sekretariatit. Struktura organizative e Sekretariatit përbëhet nga:

- Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti i Administratës dhe i Burimeve Njerëzore (DABNJ);
- Departamenti për Regjistrim të Lëndëve, Statistikë dhe Arkiv (DRLSA);
- Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP);
- Departamenti për Buxhet dhe Financa (DBF);
- Zyra për Komunikim dhe Informim (ZKI);
- Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB);
- Njësia e Prokurimit (NJP); dhe
- Njësia e Teknologjisë së Informacionit, e Komunikimit dhe Multimedieve (NJTIKM).

Në realizimin e objektivave të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2021-2025 (në tekstin e mëtejshëm: Plani Strategjik i Gjykatës 2021-2025), për shkak të kufizimeve nga pandemia Covid-19, nga **104** aktivitete të parapara për zhvillim gjatë vitit 2021, **44** prej tyre janë realizuar me sukses apo **42.31%**.

Funksionimi i Njesisë Ligjore (NJL), e përbërë nga këshilltarët kushtetues-juridikë dhe personeli tjetër ligjor, si dhe struktura dhe organizimi i saj, janë përcaktuar me Rregulloren e Njesisë Ligjore nr. 03/2019 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e Njesisë Ligjore). Këshilltarët kushtetues-juridikë mbështesin punën profesionale të gjyqtarëve.

Gjatë vitit 2021, Sekretariati i Gjykatës ka realizuar këto objektiva:

- Implementimi i Planit Strategjik të Gjykatës 2021-2025;
- Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2022-2024; dhe
- Hartimi i Regjistrimit të Rrezikut për vitin 2021.

Gjatë vitit të kaluar, Sekretariati i Gjykatës gjithashtu publikoi:

- Raportin vjetor të punës për vitin 2020;
- Raportin vjetor të mediave për vitin 2021;
- Buletinin informativ nr. 11 (korrik-dhjetor 2020);
- Buletinin informativ nr. 12 (janar-qershor 2021);
- Planin Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2021-2025; dhe
- Buletinin e Praktikës Gjyqësore për vitin 2020.

NJËSIA LIGJORE

NJËSIA LIGJORE

Njësia Ligjore është strukturë e veçantë organizative e Gjykatës Kushtetuese e themeluar bazuar në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, Rregulloren e punës së Gjykatës, si dhe Rregulloren e Njesisë Ligjore. Njësia Ligjore i përgjigjet drejtpërdrejt Kryetarit/es dhe gjyqtarëve të Gjykatës.

Roli parësor i Njesisë Ligjore është që të ofrojë mbështetje profesionale për gjyqtarët e Gjykatës duke bërë hulumtime dhe analiza ligjore dhe duke ndihmuar në hartimin e raporteve paraprake, vendimeve si dhe materialit tjetër ligjor që është i nevojshëm për punën e Gjykatës. Në këtë drejtim, Njësia Ligjore është përgjegjëse që të ndihmojë Gjykatën drejt sigurimit të një kualiteti të lartë të vendimmarrjes dhe të konsistencës së praktikës gjyqësore. Për të tilla qëllime, Njësia Ligjore, mes tjerash, kryen hulumtime shteruese ligjore në nivel të (i) të drejtës kombëtare; (ii) të drejtës kushtetuese rajonale dhe ndërkombëtare; (iii) të drejtës ndërkombëtare dhe asaj krahasuese; (iv) opinioneve, rekomandimeve dhe praktikave të mira të nxjerra nën ombrellën e Këshillit të Evropës dhe Komisionit të Venecias; (v) praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; dhe, sipas nevojës, edhe të (vi) gjykatave të tjera ndërkombëtare. Po ashtu, Njësia Ligjore (vii) përgatit materiale të ndryshme për diskutim dhe vendosje përgjatë seancave administrative të Gjykatës, si dhe seancave profesionale që mbahen me gjyqtarët dhe këshilltarët e Gjykatës.

Funksionet e tjera të rëndësishme të Njesisë Ligjore janë: (i) takimi me palët dhe asistimi i Sekretariatit në pranimin e kërkesave dhe dokumenteve shtesë; (ii) filtrimi i të gjitha kërkesave të reja të dorëzuara në Gjykatë dhe hartimi i një raporti fillestar filtrues në lidhje me kërkesat e dorëzuara nga palët; (iii) identifikimi i kërkesave me masë të përkohshme dhe urgjencave të tjera që një kërkesë mund të paraqesë varësisht nga natyra e rastit; dhe (iv) mbajtja dhe përditësimi i bazave të të dhënave siç janë: baza e të dhënave e llojit të kërkesave dhe pretendimeve të ngritura, baza e të dhënave për zbatimin e vendimeve të Gjykatës, dhe po ashtu baza e të dhënave për përcjelljen e statusit të secilit rast që nga fillimi e deri në publikimin e tij. Të gjitha vendimet e Gjykatës klasifikohen sipas sistemit të filtrimit nga Njësia Ligjore para publikimit në ueb-faqen e Gjykatës sipas kriterëve të paracaktuara me qëllim të ofrimit të mundësisë për një kërkim më të lehtë shkencor, profesional dhe akademik për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe komunitetin juridik që i qasen vendimeve përmes ueb-faqes së saj.

Njësia Ligjore përbëhet nga: Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik; Juriskonsulti; Zëvendëskëshilltarët e Parë Kushtetues Juridikë; Këshilltarët e Lartë Kushtetues Juridikë; Këshilltarët Kushtetues Juridikë; dhe Këshilltari i Lartë për Administrimin e Kërkesave. Aktualisht, Njësia Ligjore përbëhet nga 16 anëtarë dhe udhëheqet dhe mbikëqyr nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik i cili ndihmohet nga dy Zëvendëskëshilltarët e Parë Kushtetues Juridikë. Që të tre këta të fundit, si dhe Juriskonsulti, zgjidhen nga gjyqtarët e Gjykatës nga radha e këshilltarëve të lartë kushtetues juridikë për një periudhë tri (3) vjeçare. Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik, mes tjerash, ndihmon dhe këshillon Gjykatën në kryerjen e funksioneve të saj, mbështet të gjithë anëtarët e Njesisë Ligjore në kryerjen e detyrave të tyre, mbikëqyr organizimin, aktivitetin dhe performancën e anëtarëve të Njesisë Ligjore, si dhe mbikëqyr draftimin e raporteve paraprake dhe kryerjen e detyrave të tjera. Ndërsa roli i Juriskonsultit është që të këshillojë Gjykatën dhe ta njoftojë atë për çështje të ndryshme që ndërlidhen me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe praktikën e re të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) me synim të sigurimit të konsistencës së praktikës gjyqësore. Në bashkërendim me Këshilltarin e Parë Kushtetues Juridik, Juriskonsulti ndihmon dhe propozon rekomandime përkatëse me qëllim të sigurimit të kualitetit të lartë të vendimmarrjes dhe konsistencës së praktikës gjyqësore të Gjykatës.

Anëtarët e Njesisë Ligjore kanë role specifike të krijuara për nevojat e Gjykatës. Ata kanë statusin e të punësuarit me kohë të pacaktuar dhe kushtet specifike të punës dhe përshkrimet e sakta të detyrave të tyre të punës janë të përcaktuara me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, Rregulloren e punës së Gjykatës dhe Rregulloren e Njesisë Ligjore. Sa i përket këshillimeve që ofrojnë, ata janë të pavarur dhe të lirë të shprehin mendimin e tyre profesional në lidhje me çdo kërkesë në të cilën ata punojnë.

Njësia Ligjore mban takime të rregullta lidhur me organizimin e punës së saj, duke përfshirë por mos u kufizuar në: (i) përcjelljen e statusit të rasteve; (ii) diskutimin e çështjeve të ndryshme juridiko-kushtetuese; (iii) propozimin e akteve të brendshme të Gjykatës; si dhe (iv) për të diskutuar rreth praktikës gjyqësore të vet Gjykatës dhe GJEDNJ-së. Faktor i rëndësishëm në sigurimin e vendimmarrjes efikase juridike dhe të ngritjes së kualitetit të hartimit të raporteve dhe të vendimeve, është trajnimi i këshilltarëve profesional të Gjykatës në fushën e së drejtës kushtetuese, ndërkombëtare dhe të të drejtave të njeriut. Në kuadër të aktiviteteve të Gjykatës, anëtarët e Njesisë Ligjore kanë marrë pjesë në punëtori profesionale gjatë tërë vitit. Lista e plotë e aktiviteteve të këshilltarëve juridikë mund të gjendet në pjesën e këtij raporti - Aktivitetet e Gjykatës.

Përgjatë vitit 2021, përkundër vështirësive të jashtëzakonshme që ka paraqitur pandemia COVID-19, Njësia Ligjore ka arritur që t'i përmbushë të gjitha detyrat e saj drejt ofrimit të mbështetjes së gjyqtarëve në trajtimin e rasteve që janë paraqitur në Gjykatë. Përkundër këtyre vështirësive, puna ka vijuar pa pengesa, ku gjatë një pjese të vitit është kryer përmes organizimit të punës me kujdestari në zyrë dhe përmes platformës online – varësisht nga rekomandimet e dhëna të ekspertëve të shëndetit publik. Përgjatë këtij viti janë trajtuar një numër i lartë i rasteve në të cilat Njësia Ligjore ka dhënë kontribut të vazhdueshëm në procesin e analizimit të rasteve, përgatitjes së hulumtimeve ligjore dhe hartimit të vendimeve, bazuar në vendimmarrjen e gjyqtarëve të Gjykatës.

Njësia Ligjore vazhdon të jetë e përkushtuar në ngritjen e profesionalizmit të saj, nëpërmjet realizimit të projekteve të ndryshme që ofrohen dhe mundësohen nga partnerët strategjikë të Gjykatës. Në vazhdimësi dhe përgjatë gjithë vitit, Gjykata është e hapur për të ofruar takime me studentë apo nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, qoftë edhe të formatit online, me qëllim që të njoftojë të gjithë të interesuarit lidhur me punën e Gjykatës, rolin e saj të përcaktuar me Kushtetutë si dhe kërkesat që paraqiten pranë saj.

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE
NJERËZORE**

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE

I. Burimet njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve

Gjatë vitit 2021, Departamenti i Administratës dhe Burimeve Njerëzore (në tekstin e mëtejshëm: DABNJ) në zbatim të planit të punës, ka mbështetur mbarëvajtjen e punës së Sekretarisë në përputhje me mandatin e saj.

Gjatë kësaj periudhe, në përputhje me shënimet e personelit, u ndërmorën këto aktivitete:

- Organizimi i një (1) konkursi të jashtëm për plotësimin e dy (2) pozitave: këshilltarë të lartë kushtetues juridik, ku kandidatet e përzgjedhura filluan punën më 1 tetor 2021;
- Organizimi i katër (4) procedurave të avancimit, përmes konkurseve të brendshme për plotësimin e pozitave: një (1) menaxher i zyrës në Kabinetin e Kryetares, një (1) menaxher i koordinimit të punës në DRLSA; një (1) menaxher i koordinimit në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm; dhe dy (2) specialistë të shërbimeve gjuhësore;
- Në zbatim të Vendimit të Seancës Administrative, janë ngritur koeficientët dhe shtesat për pesë (5) pozita: zyrtar zotues, zyrtar për logjistikë, zyrtar për arkiv, zyrtar në DRLSA (ish recepsionist) dhe vozitës i Kryetares;
- Shtatë (7) zyrtarë të Gjykatës mbushën dhjetë (10) vite pune të pandërprerë në Gjykatë gjatë vitit 2021 dhe të njëjtit u shpërblyen me pagën jubilarë;
- Janë përgatitur dhe ofruar vërtetime të dëshmisë së punësimit sipas kërkesave të zyrtarëve. Në baza të rregullta është evidencuar vijueshmëria e stafit si dhe është bërë përditësimi i evidencës së pushimeve vjetore dhe mjekësore;
- Sa i përket pushimeve të veçanta, tre (3) zyrtarë të Gjykatës kanë shfrytëzuar pushimet e veçanta, përkatësisht një (1) këshilltar i lartë ka shfrytëzuar pushimin pa pagesë, një (1) zyrtarë gjendet në pushim prindëror me 70% të pagës si dhe një (1) zyrtarë e emëruar në funksion publik vazhdon të ushtrojë të drejtën për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës;
- Sa i përket zbatimit të Planit Strategjik, janë mbajtur dy punëtori: Punëtorja e katërt dhe përmblylëse për vitin 2020 së bashku me regjistrin e rrezikut, si dhe Punëtorja e parë për vitin 2021 në lidhje me aktivitetet e zhvilluara për periudhën prill-shtator 2021;
- Në fund të kësaj periudhe ka filluar procesi i vlerësimeve vjetore të rezultateve të punës për gjithë stafin e Gjykatës;
- Është bërë përditësimi i evidencës së pushimeve vjetore për të gjithë stafin si dhe janë përcjellë njoftimet për shfrytëzimin e pushimit vjetor të mbetura, dhe mundësinë e bartjes së 12 ditëve në vitin vijues, sipas dispozitave ligjore në fuqi;
- Në kuadër të ndryshimeve në listën e pagave dhe të dhënave statistikore përgjatë vitit 2021, ka pasur:
 - katër (4) punonjës të ri;
 - katër (4) pozita të reja;

- pesë (5) ndryshime koeficientësh;
- një (1) pushim prindëror; dhe
- një (1) pushim pa pagesë.

Për sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore, përgjatë vitit ka pasur këto ndryshime:

- një (1) dorëheqje nga pozita gjyqtar;
- një (1) përfundim mandati, nga pozita Kryetare/Gjyqtare; dhe
- një (1) zyrtar është pensionuar me pension të parakohshëm.

Nga numri i përgjithshëm prej shtatëdhjetë (70) punëtorë të lejuar me buxhetin e vitit 2021, në fund të kësaj periudhe, numri i përgjithshëm i të punësuarve në listën e pagave të muajit dhjetor 2021 është gjashtëdhjetë e nëntë (69) të punësuar, prej të cilëve:

Numri i të punësuarve sipas gjinisë:

- 34 apo 49.28%, janë të gjinisë mashkullore; dhe
- 35 apo 50.72%, të gjinisë femërore.

Numri i të punësuarve sipas përkatësisë nacionale:

- 63 apo 91.3%, janë shqiptarë;
- 3 apo 4.35%, janë serbë;
- 2 apo 2.09%, janë boshnjak; dhe
- 1 apo 1.45% malazias.

Në këtë numër janë përfshirë edhe dy ish kryetarët e Gjykatës si dhe katër zyrtarët e emëruar sipas ligjit në fuqi.

Figura nr. 1: Numri i të punësuarve sipas përkatësisë nacionale:





Figura nr. 2: Numri i të punësuarve sipas gjinisë:



II. Ngritja e kapaciteteve (trajnimet dhe zhvillimi i karrierës)

Gjatë vitit 2021, DABNJ hartoi planin e ndërtimit të kapaciteteve për stafin kushtetues administrativ, bazuar në identifikimin e nevojave të zyrtarëve nga planet individuale të trajnimeve, si dhe në vazhdimësi janë përditësuar dhe evidentuar të gjitha aktivitetet e stafit përgjatë këtij viti.

Në vitin 2021, si pasojë e gjendjes pandemike me Covid-19 u pamundësua realizimi i plotë i planit të trajnimeve. Aktivitetet e realizuara janë kombinuar në dy forma, virtualisht dhe me prezencë fizike. Në tërësi u realizuan gjithsej 49 aktivitete, si në vijim:

- tre (3) vizita zyrtare;
 - tre (3) punëtori në lidhje me Planin Strategjik;
 - dy (2) punëtori orientuese për punonjësit e ri;
 - dy (2) shkolla verore;
 - gjashtë (6) konferenca;
 - dy (2) forume dhe uebinar;
 - dy (2) tryeza të rrumbullakëta;
 - dy (2) seanca profesionale dhe informuese; dhe
 - njëzet e shtatë (27) trajnime profesionale.
-
- Më 15 janar 2021, është mbajtur një “Prezantim Online” për zyrtarin kryesor financiar, zyrtarin e pranimit të mallit dhe për zyrtarin zotues, në të cilën morën pjesë tre (3) pjesëmarrës;
 - Më 21 janar 2021, është mbajtur trajnimi në modulën “Pamje dhe Raportim”, i organizuar nga Thesari i Kosovës, në të cilin mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
 - Më 2-3 shkurt 2021, përmes platformës online, është mbajtur trajnimi “Njohja me organizimin në Administratën Publike”, i organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (në tekstin e mëtejshëm: IKAP), në të cilin mori pjesë një (1) pjesëmarrës;


- Më 2 shkurt 2021, në objektin e Gjykatës është mbajtur “Punëtoria Orientuese për punonjësit e rinj të Gjykatës Kushtetuese”, në të cilin morën pjesë shtatë (7) pjesëmarrës;
- Më 3 shkurt 2021, në formën online, është mbajtur trajnimi me temën “Sigurimi i Cilësisë në AB”, i organizuar nga NJQH/AB, në të cilin mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
- Më 4 shkurt 2021, në objektin e Gjykatës është zhvilluar “Punëtoria e fundit në lidhje me Planin e Veprimit të Planit Strategjik 2018-2020”, në të cilën morën pjesë pesë (5) pjesëmarrës;
- Më 9 shkurt 2021, përmes platformës online, është organizuar punëtoria “Zhvillimi i Planit Strategjik 2021-2025 i Gjykatës Kushtetuese së bashku me Planin e Veprimit”, në të cilën morën pjesë njëzet e nëntë (29) pjesëmarrës;
- Më 10-11 shkurt 2021, përmes platformës online, është mbajtur trajnimi me temën “Aftësimi për Hartimin e Strategjive, Monitorimi dhe Vlerësimi i tyre”, i organizuar nga IKAP, në të cilën morën pjesë tre (3) pjesëmarrës;
- Më 19 shkurt 2021, është mbajtur uebinari me temën “Të drejtat pronësore”, i mbështetur nga Këshilli i Evropës, në të cilën morën pjesë trembëdhjetë (13) pjesëmarrës;
- Më 23 shkurt 2021, në formën online është mbajtur “Seancë Informuese lidhur me Standardet e Raportimit dhe Menaxhimi i Rrezikut”, në të cilën mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
- Më 23-24 shkurt 2021, përmes platformës online është mbajtur trajnimi “Lidershipi dhe Menaxhimi në Administratë Publike”, i organizuar nga IKAP, në të cilin morën pjesë pesë (5) pjesëmarrës;
- Më 25-26 shkurt 2021, përmes platformës online është mbajtur trajnimi “E drejta e Informimit dhe Administrata Publike”, i organizuar nga IKAP, në të cilin mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
- Më 8-9 mars 2021, përmes platformës online është mbajtur trajnimi “Modeli i Kostimit Standard”, i organizuar nga IKAP, në të cilin mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
- Më 16-17 mars 2021, përmes platformës online është mbajtur trajnimi “Lidershipi dhe Menaxhimi në Administratë Publike”, i organizuar nga IKAP, në të cilin morën pjesë dy (2) pjesëmarrës;
- Më 30-31 mars 2021, përmes platformës online është mbajtur trajnimi “Njohja me organizimin dhe vendimmarrjen në Administratë Publike”, i organizuar nga IKAP, në të cilin mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
- Më 7 prill - 12 maj 2021, përmes platformës online është mbajtur trajnimi me temën “Trajnimi i Sundimit të Ligjit MaTra mbi Financat Publike dhe Prokurimin”, i organizuar nga Netherlands Helsinki Committee, në të cilën mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
- Më 19-21 prill 2021, në Cactus, Prishtinë, është mbajtur trajnimi me temën “Kompetenca e Burimeve Njerëzore – Moduli i Trajnimit”, i organizuar nga Hoja Consulting, në të cilin mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
- Më 22-23 prill 2021, përmes platformës online, është mbajtur trajnimi me temën “Menaxhimi i Stresit”, i organizuar nga IKAP, në të cilin morën pjesë tre (3) pjesëmarrës;

- Më 6 maj 2021, përmes platformës online, është ndjekur Konferenca me temën “Afrimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me Mbajtësit e të Drejtave”, e mbështetur nga Këshilli i Evropës, në të cilën morën pjesë njëzet e tre (23) pjesëmarrës;
- Më 11 maj 2021, përmes platformës online është mbajtur trajnimi “Menaxhimi i kohës dhe delegimi i përgjegjësi”, i organizuar nga IKAP, në të cilin mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
- Më 20 maj 2021, përmes platformës online, është mbajtur trajnimi me temën “Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja menaxheriale”, i organizuar nga IKAP, në të cilin mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
- Më 26-27 maj 2021, në objektin e IKAP, është mbajtur trajnimi me temën “Menaxhimi i kontratave përmes e-prokurimit”, në të cilin morën pjesë tre (3) pjesëmarrës;
- Më 28 maj 2021, përmes platformës online është mbajtur trajnimi me temën “Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Kërkesave”, i organizuar nga IKAP, në të cilin morën pjesë dy (2) pjesëmarrës;
- Më 27-28 maj 2021, është realizuar një vizitë e delegacionit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, e organizuar nga dy gjykatat përkatëse, në të cilën morën pjesë dhjetë (10) pjesëmarrës nga ana e delegacionit nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë;
- Më 1-2 qershor 2021, në objektin e IKAP-it, është mbajtur trajnimi me temën “Programi i Investimeve Publike (PIP) dhe Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB)”, i organizuar nga IKAP në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), në të cilin morën pjesë katër (4) pjesëmarrës;
- Më 8-10 korrik 2021, në Sarandë është mbajtur “Tryezë pune e stafit të Gjykatës Kushtetuese mbi zbatimin e Dokumentit Strategjik dhe Planit të tij të Veprimit”, organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në të cilën morën pjesë dy (2) pjesëmarrës nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës;
- Më 23 korrik 2021, në kuadër të përmbylljes së projektit për “Search Server” dhe “E-library”, të mbështetur nga Këshilli i Evropës, është mbajtur trajnimi mbi përdorimin e platformës “ProQuest E-book”, nga kompania implementuese ProQuest Training and Consulting, në të cilin morën pjesë tetë (8) pjesëmarrës;
- Më 29 gusht - 1 shtator 2021, në Bled të Sllovenisë është mbajtur konferenca me temën “Forumi Strategjik i Bled dhe Forumi Strategjik i të Rinjve të Bled”, e organizuar nga CEP dhe MPJ, në të cilën mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
- Më 3-4 shtator 2021, në Prishtinë është mbajtur “Forumi i 8-të Rajonal i Sundimit të Ligjit për Evropën Perëndimore”, i organizuar nga Aire Centre, Civil Rights Defenders, në të cilin morën pjesë tre (3) pjesëmarrës;
- Më 7-8 shtator 2021, përmes platformës online, është mbajtur Shkolla e 9-të Verore, organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Turqisë, në të cilën morën pjesë tre (3) pjesëmarrës;
- Më 9 shtator 2021, në Prishtinë është mbajtur trajnimi me temën “Zbatimi në Praktikë i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike”, i organizuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi në bashkëpunim me GIZ-in, në të cilin mori pjesë një (1) pjesëmarrës;

- Më 15-16 shtator 2021, në Tiranë është mbajtur Shkolla Verore me temën “Universiteti i 5-të Veror në Ballkan 2021: Kriza e Sundimit të Ligjit në Ballkan dhe BE”, e organizuar nga Universiteti i Tiranës, në të cilën mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
- Më 16 shtator 2021, në Prishtinë është mbajtur trajnimi me temën “Zbatimi në Praktikë i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, e organizuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi në bashkëpunim me GIZ-in, në të cilin mori pjesë një (1) pjesëmarrës nga Gjykata Kushtetuese;
- Më 29 shtator - 1 tetor 2021, në Vlorë është mbajtur një tryezë e rrumbullakët me temën “Praktika gjyqësore në vlerësimin e mosmarrëveshjeve të kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore”, e organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, në të cilën morën pjesë dymbëdhjetë (12) pjesëmarrës nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës;
- Më 29-30 shtator 2021, në objektin e IKAP është mbajtur trajnimi me temën “Menaxhimi i kontratave përmes e-prokurimit”, i organizuar nga IKAP, në të cilin morën pjesë katër (4) pjesëmarrës;
- Më 15 tetor 2021, u mbajt “Punëtorja orientuese për punonjësit e rinj” në objektin e Gjykatës, në të cilën morën pjesë dhjetë (10) pjesëmarrës;
- Më 19 tetor 2021, u organizua “Trajnim prezantues për përdorimin e tri platformave elektronike në kuadër të platformës Search Engine”, përmes platformës ZOOM, në të cilin morën pjesë gjashtë (6) pjesëmarrës;
- Më 27 tetor 2021, u organizua seancë profesionale me temën “Shqyrtimi i kërkesave për masë të përkohshme”, në Hotel Emerald në Prishtinë, në të cilën morën pjesë njëzet e katër (24) pjesëmarrës;
- Më 2 nëntor 2021, është mbajtur “Punëtorja e parë e planit të zbatimit të Planit Strategjik 2021-2025, për vitin 2021” në Gjykatë, në të cilën morën pjesë dhjetë (10) pjesëmarrës;
- Më 11 nëntor 2021 në objektin e IKAP është mbajtur trajnimi me temën “Planifikimi strategjik, treguesit e performancës, udhëzimet administrative në fushën e planifikimit buxhetor dhe ndryshimeve buxhetore: Përgatitja e propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore për vitin fiskal mbi bazën e LMPP” organizuar nga IKAP, në të cilin morën pjesë dy (2) pjesëmarrës;
- Më 12 nëntor 2021, u mbajt Konferenca ndërkombëtare me temën “Të drejtat e patjetërsueshme dhe traditat e konstitucionalizmit” organizuar nga Instituti Kellog për Studime Ndërkombëtare në Universitetin Notre Dame në SHBA, në të cilën morën pjesë dy (2) pjesëmarrës nga Gjykata;
- Më 16-17 nëntor 2021, në objektin e IKAP është mbajtur trajnimi me temën “Ekzekutimi i buxhetit dhe raportimi i shpenzimeve”, organizuar nga IKAP, në të cilin mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
- Më 18-19 nëntor 2021, në objektin e IKAP është mbajtur trajnimi me temën “Etika dhe integriteti në Administratën Publike”, organizuar nga IKAP, në të cilin morën pjesë katër (4) pjesëmarrës;
- Më 23 nëntor 2021, u mbajt “Konferenca për siguri Kibernetike”, organizuar nga Ambasada Amerikane, në Hotel Emerald në Prishtinë, në të cilin morën pjesë dy (2) pjesëmarrës nga Gjykata;

- Më 24 nëntor 2021, u mbajt tryeza me temën “Gratë në drejtësinë komerciale”, organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane dhe USAID, në Hotel International Prishtina, në të cilën mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
- Më 1 dhjetor 2021, u mbajt trajnimi online me temën “HUDOC” organizuar nga Këshilli i Evropës, përmes platformës ZOOM, në të cilin morën pjesë pesëmbëdhjetë (15) pjesëmarrës nga Gjykata;
- Më 7 dhjetor 2021, në Shkup u organizua takim i përbashkët mes Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut, në të cilin morën pjesë dymbëdhjetë (12) pjesëmarrës;
- Më 10 dhjetor 2021, në Prishtinë u organizua konferenca me temën “Zvarritja e procedurave gjyqësore, shkelje e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm”, mbajtur në Hotel Sirius, në të cilën mori pjesë një (1) pjesëmarrës;
- Më 13-15 dhjetor 2021, në Tiranë është mbajtur konferenca ndërkombëtare me temën “Çështja e të zhdukurve me forcë dhe në mënyrë të pavullnetshme” organizuar nga OSCE në bashkëpunim me Qendrën për Drejtësi dhe Transformim në Universitetin e Tiranës, në të cilën mori pjesë një (1) pjesëmarrës; dhe
- Më 16 dhjetor 2021, në Prishtinë është mbajtur trajnimi me temën “Adresimi i diskriminimit gjinor në vendin e punës - Zbatimi i politikës kundër ngacmimit seksual në organet e administratës publike,” organizuar nga IKAP në bashkëpunim me UN Women, në Villa Gërmia, në të cilin mori pjesë një (1) pjesëmarrës.

Figura nr. 3: Pjesëmarrja e stafit të Gjykatës Kushtetuese në vizita studimore, konferenca, punëtori, shkolla verore, trajnime dhe kurse të gjuhëve të huaja, brenda dhe jashtë Kosovës:



III. Mbështetja administrative dhe logjistike

- DABNJ ka siguruar ofrimin e shërbimeve administrative dhe të shërbimeve tjera që ndihmojnë në kryerjen dhe shtimin e efikasitetit në punë për të gjithë stafin e Gjykatës;

- Është organizuar dhe bërë pranimi dhe shpërndarja e inventarit për të punësuarit e ri dhe janë furnizuar të gjithë të punësuarit në Gjykatë me pajisje të nevojshme të teknologjisë informative (në tekstin e mëtejme: TI);
- Është bërë regjistrimi, mirëmbajtja dhe servisimi i rregullt i veturave të Gjykatës dhe përpilimi i raporteve të veçanta për shpenzimet e derivateve;
- Është kryer kontrolli i hyrje-daljeve të materialit shpenzues dhe pajisjeve të TI-së, si dhe është bërë regjistrimi i tij në Sistemin e Menaxhimit të Informatave të E-pasurisë;
- Pas furnizimit me material shpenzues dhe të pajisjeve të TI-së, si dhe shërbimeve për nevoja pune të Gjykatës, është bërë regjistrimi i 225 faturave në Sistemin Free Balance;
- Janë përpiluar raporte të veçanta lidhur me ngarkimin apo shkarkimin me pajisje pune për të punësuarit e Gjykatës; dhe
- Janë përpiluar një seri shkresash drejtuar institucioneve të ndryshme lidhur me ekzekutimin e kërkesave të ndryshme administrative dhe ofrimin e shërbimeve për nevoja të Gjykatës.

IV. Biblioteka e Gjykatës

Nga fusha e bibliotekës janë kryer këto aktivitete, përkatësisht është pranuar dhe regjistruar kjo literaturë:

- Ka vazhduar anëtarësimi vjetor i Gjykatës në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës (ABEK), përmes së cilit ofrohet qasja në këto burime elektronike: (i) Cambridge Journals Online, (ii) Edward Elgar Publishing, (iii) IMF- International Monetary Fund, (iv) Open Edition Journals dhe (v) ASTM - Compass;
- Ka vazhduar abonimi vjetor i Gjykatës në burimet elektronike të Gazetës Universitare të Oksfordit, përmes së cilave ofrohet qasja në këto burime elektronike: (i) Max Planck Encyclopedia of International Law, (ii) ORIL - International Human Rights Law, (iii) ORIL - International Law in European Courts dhe (iv) Oxford Constitutions of the World;
- Koalicioni Ndërkombëtar i Konsorciumit të Bibliotekave ka mundësuar qasjen pa pagesë në një listë të gjerë të burimeve elektronike, kryesisht të fushës akademike, gjatë periudhës së Covid-19;
- Me mbështetjen e Këshillit të Evropës, ka përfunduar me sukses implementimi i projektit për “Search Server” dhe “E-librarinë” e Gjykatës. Përmes këtij projekti është krijuar një platformë e brendshme në të cilën janë integruar së bashku:
 - Të gjitha vendimet e publikuara të Gjykatës, ligje e dokumente tjera ligjore;
 - Katalogu elektronik i librave të Gjykatës “Koha Library”, i cili njëkohësisht është përditësuar në versionin më të fundit; dhe
 - Databaza “HUDOC” e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Përmes projektit E-library të mbështetur nga Këshilli i Evropës, janë pranuar 28 libra elektronik dedikuar Gjykatës Kushtetuese, përmes platformës [ProQuest Ebook Central](#), e cila mundëson leximin online, shkarkimin dhe printimin e disa materialeve;

- Është përgatitur raporti përmbledhës i shërbimeve të Bibilotekës, me theks në burimet elektronike dhe databazat e katalogut të Bibliotekës;
- Është përgatitur draft Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Bibliotekës së vitit 2013;
- Janë shërbyer gjyqtarët dhe stafi i Gjykatës me literaturë fizike dhe elektronike, sipas kërkesave të tyre, si dhe janë shkarkuar artikuj të fushës juridike, sipas rëndësisë së tyre;
- Sa i përket titujve të rinj, gjatë kësaj periudhe Biblioteka e Gjykatës ka pranuar dhe regjistruar këta tituj:
- ICL Journal: Vienna Journal on International Constitutional Law, 2021, volume 14;
- Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar (1912-1913);
- Les Cahiers Du Conseil Constitutionnel Titre, volume 3, 2019-2020;
- Commission de Venise - Lettre d'information FR 1/2021;
- Democracy, Peace and the UN - bringing Kant to the east river, nga Bekim Sejdiu;
- ICL Journal: Vienna Journal on International Constitutional Law, 2021, volume 15;
- Përmirësimi i mbrojtjes së standardeve evropiane të të drejtave të njeriut nga Gjykata Kushtetuese, i cili përfshinë 4 publikime, në tri gjuhët:
 - (i) Shpifja dhe Mbrojtja e Reputacionit - doracak i rasteve kryesore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nga Flutura Kusari;
 - (ii) E drejta e Lirisë së Shprehjes - doracak i rasteve kryesore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nga Flutura Kusari;
 - (iii) Kohëzgjatja e Arsyeshme e procedurës: Përmbledhje e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nga Maria Filatova;
 - (iv) Doktrinat dhe metodologjia e Interpretimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga ana e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e njeriut, nga Jeremy McBride;
- ICL Journal: Vienna Journal on International Constitutional Law, volume 15 issue 2 dhe issue 3, nga Christoph Bezemek, Harald Eberhard dhe Claudia Fuchs;
- Pavarësia dhe Paanshmëria e Gjyqësorit (Shikimi mbi jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut), donacion nga Civil Rights Defenders;
- Janë pranuar dhe regjistruar botimet nga Zyra për publikimin e Gazetës Zyrtare me nga tre kopje:
 - gazeta zyrtare nr. 07/2020, për muajin dhjetor 2020;
 - gazeta zyrtare nr. 01/2021, për muajin janar 2021; dhe
 - gazeta zyrtare nr. 03/2021, për muajin gusht 2021.

**DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE,
STATISTIKËS DHE ARKIVIT**

DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE, STATISTIKËS DHE ARKIVIT

Statusi i lëndëve

Gjatë vitit 2021, Gjykata ka pasur në punë gjithsej 421 kërkesa/lëndë, nga të cilat 235 janë pranuar në vitin 2021 kurse 186 janë bartur nga vitet e kaluara:

- 1 kërkesë e vitit 2018 është zgjidhur;
- 53 kërkesa të vitit 2019 janë bartur, prej të cilave 52 janë zgjidhur, ndërsa 1 është në proces;
- 132 kërkesa të vitit 2020 janë bartur, prej të cilave 122 janë zgjidhur, ndërsa në proces janë 10 kërkesa; dhe
- 235 kërkesa janë pranuar në vitin 2021, prej të cilave 101 janë zgjidhur dhe në proces janë 134 kërkesa.


Në këtë periudhë, 276 kërkesa janë zgjidhur ose 65.56%. Rrjedhimisht, në këtë vit janë zgjidhur 70 kërkesa më shumë se në vitin e kaluar.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, 245 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës dhe janë përcjellur tek palët, ndërsa 4 të tjera të zgjidhura janë në proces të përgatitjes.

Në anën tjetër, gjatë kësaj periudhe janë pranuar mesatarisht 19.5 kërkesa në muaj, ndërsa janë zgjidhur 23.

Dinamika mujore e kërkesave të pranuar dhe të zgjidhura është si në vijim:

Grafikoni nr. 1: Dinamika e kërkesave sipas muajve (1 janar – 31 dhjetor 2021)



Parashtrimi i kërkesave

Juridiksioni dhe palët e autorizuar për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese është i përcaktuar me Kushtetutë dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.

Departamenti për regjistrimin e lëndëve, statistikës dhe arkivit (në tekstin e mëtejshëm: DRLSA) gjatë vitit 2021 ka pranuar 235 kërkesa të reja.

Struktura e kërkesave të parashtruara gjatë vitit 2021 është:

- 203 kërkesa kanë qenë individuale (nga personat fizikë), ose 86,4%; kurse
- 32 kërkesa janë paraqitur nga autoritetet publike (nga personat juridikë), ose 13,6%.

Shpërndarja e kërkesave

Në përputhje me nenin 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, DRLSA i ka proceduar të gjitha kërkesat e parashtruara sipas nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

Shpërndarja e kërkesave/lëndëve për gjyqtarët raportues është bërë në përputhje me rregullin 10 dhe 36 (Emërimi i gjyqtarit raportues) të Rregullores së punës të Gjykatës. Përjashtim nga ky rregull është shpërndarja e kërkesave për vënien e masës së përkohshme, të cilat kërkesa procedohen sipas rregullit 57 (Vendimi për masë të përkohshme) të Rregullores së punës së Gjykatës, dhe rasteve *ad hoc*, të cilat paraqesin konflikt interesi, në përputhje me nenin 18 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat dhe në pajtim me rregullin 9 (Procedurat për përjashtim) të Rregullores së punës së Gjykatës.

Qasja në Gjykatë dhe besimi i publikut në punën e Gjykatës


Të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht përkatësisë etnike, fetare apo gjinore, kanë qasje të barabartë në Gjykatë.

Qasja etnike e individëve tregohet si në vijim:

- 183 kërkesa janë parashtruar nga shqiptarë, ose 77.9 %;
- 10 kërkesa janë parashtruar nga komuniteti serb, ose 4.3 %; dhe
- 7 kërkesa janë parashtruar nga nacionalitetet tjera, ose 3%.

Në anën tjetër, 35 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet publike (personat juridikë), ose 14,9%.


Grafikoni nr. 2: Struktura Etnike e parashtruesve të kërkesave (1 janar – 31 dhjetor 2021)



Struktura e parashtruesve të kërkesave tregohet si në vijim:

- 26 kërkesa janë parashtruar nga gjinia femërore, ose 11,1%;
- 162 kërkesa janë parashtruar nga gjinia mashkullore, ose 68,9%;
- 10 kërkesa janë parashtruar në grup, ose 5,5%;
- 15 kërkesa janë parashtruar nga organizatat punuese, ose 9,4%; dhe
- 12 kërkesa janë parashtruar nga institucionet, ose 5,1% .

Grafikoni nr. 3 Struktura e parashtruesve të kërkesave (1 janar – 31 dhjetor 2021




Llojet e shkeljeve të supozuara

Tipologjia e shkeljeve të supozuara të Kushtetutës nga 134 kërkesat e pranuar gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2021, është si në vijim:

- Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]_36.1%
- Neni 46 [Mbrotja e Pronës]_8.6%
- Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]_3.5%
- Neni 24 [Barazia para Ligjit]_15.7%
- Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]_2.9%
- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]_3.2%
- Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]_1.3%
- Neni 26 [E Drejta e Integritetit Personal]_0.6%
- Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]_0.3%
- Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit]_0.3%
- Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]_4.2%
- Neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]_0.3%
- Neni 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër]_0.3%
- Neni 35 [Liria e Lëvizjes]_0.3%
- Neni 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike]_0.3%
- Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]_1.9%
- Neni 47 [E Drejta për Arsimin]_0.3%
- Neni 48 [Liria e Artit dhe e Shkencës]_0.3%
- Neni 50 [Të Drejtat e Fëmijës]_0.3%

- Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]_1.6%
- Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]_4.8%
- Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]_1.3%
- Neni 2 [Sovraniteti]_0.3%
- Neni 3 [Barazia para Ligjit]_0.3%
- Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]_0.3%
- Neni 7 [Vlerat]_2.2%
- Neni 12 [Pushteti Lokal]_0.6%
- Neni 16 [Epërsia e Kushtetutës]_0.3%
- Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit]_0.3%
- Neni 101 [Shërbimi Civil]_0.6%
- Neni 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]_0.3%
- Neni 58 [Përgjegjësitë e Shtetit]_0.3%
- Neni 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve]_0.3%
- Shkelje të tjera _5.4%


Grafikoni nr. 4: Tipologjia e shkeljeve të supozuara të neneve të Kushtetutës (1 janar – 31 dhjetor 2021)



Shkelësit e supozuar të të drejtave

- 199 kërkesa ose 84.7 % e të gjitha kërkesave në këtë periudhë kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave; dhe
- 36 kërkesa ose 15.3 % e të gjitha kërkesave në këtë periudhë kanë të bëjnë me autoritetet tjera publike.

Grafikoni nr. 5: Shkelësit e supozuar të të drejtave (1 janar – 31 dhjetor 2021)




Afati i zgjidhjes së kërkesave

Gjatë vitit 2021, Gjykata ka publikuar 245 vendime.

Grafikoni në vijim pasqyron dinamikën e afatit të zgjidhjes dhe publikimit të kërkesave sipas muajve dhe ditëve, i cili varion prej 4.6 muajve në 12 muaj, ose shprehur në ditë nga 127.5 ditë në 365 ditë.

Grafikoni nr. 6: Afati i zgjedhjes së kërkesave (1 janar – 31 dhjetor 2021)



Seancat dhe kolegjet shqyrtuese


Gjatë vitit 2021, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 44 seanca plenare me 288 kolegje shqyrtuese.

Rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime për papranueshmëri, aktvendime për mospërmbarim, vendim për masë të përkohshme, vendime për ndërprerje të shqyrtimit të kërkesës dhe vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër.

Struktura e 245 vendimeve të publikuara gjatë periudhës në fjalë është si në vijim:

- 32 Aktgjykime;
- 176 Aktvendime për papranueshmëri;
- 32 Refuzime të kërkesës me procedurë të shkurtër;
- 2 Vendime për ndërprerje të shqyrtimit të kërkesës;
- 1 Vendim për Masë të përkohshme;
- 2 Aktvendime për Mospërmbarim.

Grafikoni nr. 7: Struktura e vendimeve të publikuara (1 janar – 31 dhjetor 2021)



Në vitin 2021, Gjykata Kushtetuese ka publikuar 32 aktgjykime, si në vijim:

- Aktgjykim në rastin KI207/19, parashtrues NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve A.A.U.ZH.nr.20/2019, të 30 tetorit 2019; dhe A.A.U.ZH.nr.21/2019, të 5 nëntorit 2019, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës;
- Aktgjykim në rastin KO95/20, parashtrues Liburn Aliu dhe 16 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07/V-014, të 3 qershorit 2020, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Aktgjykim në rastin KI230/19, parashtrues Albert Rakipi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019;
- Aktgjykim në rastet nr. KI160/19, KI161/19, KI162/19, KI164/19, KI165/19, KI166/19, KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19, KI171/19, KI172/19, KI173/19 dhe KI178/19, parashtrues Muhamet Këndusi dhe të tjerët. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019;
- Aktgjykim në rastet nr. KI181/19, KI182/19 dhe KI183/19, parashtrues Fllanza Naka, Fatmire Lima dhe Leman Masar Zhubi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019;
- Aktgjykim në rastin KI24/20, parashtrues “PAMEX SH.P.K”. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.179/2017, të 11 nëntorit 2019;
- Aktgjykim në rastin KI86/18, parashtrues Slavica Đorđević. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, CA.nr.2093/2017, të 29 janarit 2018;

- Aktgjykim në rastet KI45/20 dhe KI46/20, parashtrues Tinka Kurti dhe Drita Millaku. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, AA.nr. 4/2020, i 19 shkurtit 2020 dhe AA.nr.3/2020, i 19 shkurtit 2020;
- Aktgjykim në rastet KI220/19, KI221/19, KI223/19 dhe KI234/19, parashtrues Sadete Koca Lila dhe të tjerët. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019;
- Aktgjykim në rastin KI177/19, parashtrues NNT “Sokoli”. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2386/2018, të 17 majit 2019;
- Aktgjykim në rastin KI195/20, parashtrues Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jo-bankar “Monego”. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP.nr. 42/2020, të 25 qershorit 2020;
- Aktgjykim në rastin KI20/21, parashtrues Violeta Todorović. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr. AC-I-16-0122, të 1 tetorit 2020;
- Aktgjykim në rastin KI113/20, parashtrues IF Skadeforsikring, nga Norvegjia. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 62/2020, të 6 prillit 2020;
- Aktgjykim në rastet KI186/19, KI187/19, KI200/19 dhe KI208/19, parashtrues Belkize Vula Shala dhe të tjerët. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019;
- Aktgjykim në rastin KI195/19, parashtrues Banka për Biznes. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ae.nr.287/18, të 27 majit 2019 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr. 330/2019, të 1 gushtit 2019;
- Aktgjykim në rastin KI51/19, parashtrues Qamil Lupçi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, A/02/68/2016, të 12 prillit 2016;
- Aktgjykim në rastin KI188/20, parashtrues “Suva Rechtsabteilung”. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.63/2019, të 15 tetorit 2020;
- Aktgjykim në rastin KI111/19, parashtrues “Kompania e Sigurimeve “SUVA Rechstabteilung”. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme E. Rev. nr. 1/2019, të 27 shkurtit 2019;
- Aktgjykim në rastin KI235/19, parashtrues “Allianz Suisse Versicherungs - Gesellschaft AG”. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës E.Rev.nr.32/2019, të 31 korrikut 2019;
- Aktgjykim në rastin KI74/19, parashtrues “SUVA Rechtsabteilung”. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 39/2018, të 8 janarit 2019;

- Aktgjykim në rastin KIo1/20, parashtrues Momir Marinković. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-I-17-0074-A123 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 8 tetorit 2019;
- Aktgjykim në rastin KI175/19, parashtrues Ismajl Zogaj. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit KMLC. nr. 129/2019 të Prokurorit të Shtetit, të 13 gushtit 2019, Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 3983/2018, të 24 majit 2019, dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-dega në Malishevë C.nr. 118/2018, të 2 shkurtit 2018;
- Aktgjykim në rastin KI120/19, parashtrues Mursel Gashi. Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-17-0568, të 14 marsit 2019;
- Aktgjykim në rastin KO127/21, parashtrues Abelard Tahiri dhe 10 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-029, të Kuvendit të Republikës së Kosovës i 30 qershorit 2021, për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Aktgjykim në rastin KI84/21, parashtrues Telekom i Kosovës Sh.A. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr.12/20, të 20 janarit 2021;
- Aktgjykim në rastin KI143/21, parashtrues Avdyl Bajgora, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. 558/2020, të 22 shkurtit 2020;
- Aktgjykim në rastin KI54/21, parashtrues Kamber Hoxha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr. 393/2020, të 1 shkurtit 2021;
- Aktgjykim në rastin KI189/20, parashtrues IPKO Telecommunications L.L.C., Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ARJ-UZPV. nr. 17/2020, të 20 janarit 2020, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës;
- Aktgjykim në rastin KIo1/21, parashtrues Ajshe Aliu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 37/2020, të 11 qershorit 2020;
- Aktgjykim në rastin KI100/21, parashtrues Moni Commerce Sh.p.k. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP-nr. 72/2020, të 28 tetorit 2020;
- Aktgjykim në rastin KO61/21, parashtrues Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 08/V-005, të 22 marsit 2021, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës; dhe
- Aktgjykim në rastin KI82/21, parashtrues Komuna e Gjakovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, UPP-APP. nr. 1/2020, të 28 tetorit 2020.

DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE

DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE

Departamenti i Përkrahjes Profesionale (në tekstin në vijim: DPP) është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale të përkthimit, të redaktimit, të lekturës dhe të harmonizimit të terminologjisë në të gjitha dokumentet e Gjykatës Kushtetuese në gjuhët në të cilat punon Gjykata.

DPP-ja ka organizuar, ka udhëhequr dhe ka mbikëqyrur punën e përkthimit (në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze edhe për ueb-faqen zyrtare të Gjykatës), të redaktimit e të lekturës (në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe) dhe të përkthimit aty për aty (simultan). Kështu, nëpër DPP kanë kaluar 33046 faqe të shkresave, të dokumenteve të ndryshme, të aktgjykimeve, të aktvendimeve, të vendimeve për heqje nga lista, të raporteve paraprake e të tjera në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe dhe në gjuhën angleze.

Përkthyesit kanë bërë 416 orë përkthime simultane në takime të rregullta, në seanca të Gjykatës, në seanca administrative, në intervista të kandidatëve për pozitat e shpallura nga Gjykata, si dhe në takime të tjera.

Në bashkërenditje me DRLSA-në, DPP-ja ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për takimet e gjyqtarëve dhe për seancat shqyrtuese e administrative.

DPP-ja ka bërë procedimin e lëndëve në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe dhe në gjuhën angleze. Njëkohësisht, ka kontribuar në publikimin e vendimeve në shqip, në serbisht, dhe në anglisht.

DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCAVE

DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCE

Mjetet e ndara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për Gjykatën Kushtetuese për vitin 2021 janë **1,864,753.00 €**, të pasqyruara sipas kategorive ekonomike në tabelën më poshtë.

Buxheti i aprovuar për periudhën janar – dhjetor 2021

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime kapitale	Subvencione dhe transfere	Gjithsej
1,178,098.00€	457,283.00€	4,000.00€	225,372.00€	0.00€	1,864,753.00€

Më 31 maj 2021, Gjykata Kushtetuese ka pranuar shkresën nga Departamenti i Buxhetit i Ministrisë së Financave, nr. ref. 858/2021, me instruksione për rishikim të buxhetit për vitin 2021. Gjykata Kushtetuese përmes shkresës nr. ref. SP-1228/21/mv, ka kërkuar të bëhet ndryshimi në kategoritë buxhetore si në vijim:

1. Nga kategoria e shpenzimeve komunale është kërkuar që shuma prej 1,350.00€ (një mijë e treqind e pesëdhjetë euro) të transferohen tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve; dhe
2. Nga kategoria e investimeve kapitale me kod të projektit (11135) softuer të transferohet shuma prej 5,000.00€ (pesë mijë euro) tek kodi i projektit (11136) Automjetet. Ky rishikim i buxhetit është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 28 korrik 2021.

Gjithashtu, më 16 shtator 2021, përmes shkresës nr. ref. SP-1976/21/mv, Gjykata Kushtetuese ka kërkuar transferimin e mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale, gjegjësisht nga projekti me titull “Renovimi i objektit të Gjykatës Kushtetuese” me kod (15556) tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve në shumë prej 33,500.00€ (tridhjetë e tre mijë e pesëqind euro). Andaj buxheti për nëntëmuor final është si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime kapitale	Subvencione dhe transfere	Gjithsej
1,178,098.00€	492,133.00€	2,650.00€	191,872.00€	0.00€	1,864,753.00€

Më 15 tetor 2021, Gjykata Kushtetuese ka pranuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve shkresën me nr. ref. 1762 me titull “Përmbyllja e vitit fiskal”, ku me qëllim të rregullimeve të brendshme, kërkohej nga organizatat buxhetore të ofrohen të dhënat për kursimet e mundshme dhe obligimet ligjore sipas kategorive të shpenzimeve. Më datë 18 tetor 2021 përmes shkresës me nr. ref. SP-2240/21/mv, Gjykata ka planifikuar që për vitin fiskal 2021 të kursejë mjete financiare në kategorinë e investimeve kapitale. Lidhur me rregullimin e brendshëm të buxhetit Gjykata Kushtetuese kërkoi që prej kategorisë së investimeve kapitale me kode të projekteve si në vijim:

1. Kodi projektit 15556 (renovimi objektit të Gjykatës) në shumën prej 49,000.00€
2. Kodi projektit 11135 (softuer) në shumën prej 5,000.00€

mjete këto të kursyera të transferohen në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve (kodi 130).

Më 30 nëntor 2021 jemi njoftuar se Qeveria e Kosovës nëpërmjet Vendimit me Nr.10/46, ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për ndryshimet dhe kursimet e buxhetit, ku është e përfshirë edhe kërkesa e Gjykatës Kushtetuese.

Në muajin dhjetor 2021 po ashtu është bërë rregullimi i buxhetit në kategorinë Paga dhe Mëditje (kodi 111), me qëllim të mbulimit të deficitit të pagave për të gjithë Gjykatën për muajin dhjetor 2021.

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencione dhe transferet	Gjithsej
1,296,201.48€	546,133.00€	2,650.00€	137,872.00€	0.00€	1,982,856.18€

Buxheti përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese pas ndryshimeve të paraqitura në SIMFK për vitin 2021, paraqitet si në vijim:

	Buxheti i aprovuar 2021 (A) €	Alokimet janar- dhjetor (B) €	Realizimet janar-dhjetor (C) €	% (C/A) €	% (C/B) €
Paga dhe mëditje	1,296,201.18	1,296,201.18	1,296,201.18	100	100
Mallra dhe shërbime	546,133.00	546,133.00	546,106.09	99.99	99.99
Shpenzime komunale	2,650.00	2,650.00	2,583.07	97.47	97.47
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	137,872.00	137,872.00	113,237.97	82.13	82.13
Donacionet	0,00	0,00	0,00	0.00	0.00
Gjithsej	1,982,856.18	1,982,856.18	1,958,128.31	98.75	98.75

Alokimet e mjeteve nga buxheti i Kosovës sipas rrjedhjes së parasë për periudhën janar – dhjetor

Në buxhetin e përgjithshëm pjesëmarrja e alokimit për vitin 2021 ka qenë 1,982,856.18€ e shprehur në përqindje 100%.

	Janar-Shtator €	Tetor €	Nëntor €	Dhjetor €	Gjithsej €	%
Paga dhe mëditje	963,981.05	111,555.15	110,860.45	109,804.53	1,296,201.18	100
Mallra dhe shërbime	442,133.00	20,000.00	23,000.00	61,000.00	546,133.00	100
Shpenzime komunale	2,650.00	0.00	0.00	0.00	2,650.00	100
Subvencione dhe transfere	0.00	0,00	0.00	0.00	0.00	0.00

Investime kapitale	191,872.00	0.00	(54,000.00)	0.00	137,872.00	100
Donacionet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	1,600,636.05	131,555.15	79,860.45	170,804.53	1,982,856.18	100

Realizimi i buxhetit për periudhën janar – dhjetor

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit për vitin 2021 është 1,958,128.31€, e shprehur në përqindje 98.75%

Realizimi i buxhetit pasqyrohet si në vijim:

	Alokimet janar – dhjetor (A) €	Realizimi janar – dhjetor (B) €	Mbetja e mjeteve (C) €	% (B/A) €
Paga dhe mëditje	1,296,201.18	1,296,201.18	0.00	100
Mallra dhe shërbime	546,133.00	546,106.09	26.91	99.99
Shpenzime komunale	2,650.00	2,583.07	66.93	97.47
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	137,872.00	113,237.97	24,634.03	82.13
Donacionet	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	1,98,856.18	1,958,128.31	24,727.87	98.75

Realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje

Realizimi i pagave dhe mëditjeve sipas muajve:

Muaji	Numri i punëtorëve	Buxheti	Realizimi	Mbetja
Janar	66	107,810.41	107,810.41	0.00
Shkurt	66	108,785.20	108,785.20	0.00
Mars	66	108,580.86	108,580.86	0.00
Prill	66	110,232.04	110,232.04	0.00
Maj	66	109,744.10	109,744.10	0.00
Qershor	65	105,739.31	105,739.31	0.00
Korrik	65	104,388.77	104,388.77	0.00
Gusht	65	104,115.99	104,115.99	0.00
Shtator	65	104,584.37	104,584.37	0.00

Tetor	68	111,555.15	111,555.15	0.00
Nëntor	69	110,860.45	110,860.45	0.00
Dhjetor	69	109,804.53	109,804.53	0.00
Gjithsej		1,296,201.18	1,296,201.18	0.00

Realizimi i buxhetit për mallra dhe shërbime

Realizimi i buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2021 të ndara sipas muajve:

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	52,000.00	52,000.00	99,519.66	(47,519.66)
Shkurt	50,000.00	50,000.00	11,537.91	38,462.09
Mars	60,000.00	60,000.00	12,546.44	47,453.56
Prill	40,000.00	40,000.00	74,671.71	(34,671.71)
Maj	52,000.00	52,000.00	76,095.98	(24,095.98)
Qershor	40,000.00	40,000.00	18,626.86	21,373.14
Korrik	30,000.00	30,000.00	77,844.03	(47,844.03)
Gusht	54,633.00	54,633.00	16,039.95	38,593.05
Shtator	63,500.00	63,500.00	12,268.84	51,231.16
Tetor	20,000.00	20,000.00	58,728.29	(38,728.29)
Nëntor	23,000.00	23,000.00	26,549.87	(3,549.87)
Dhjetor	61,000.00	61,000.000	61,676.55	(676.55)
Gjithsej	546,133.00	546,133.00	546,106.09	26.91

Buxheti i ndarë për investime kapitale sipas kodeve të projekteve

Projektet	Kodet e projekteve	Buxheti i aprovuar €	Realizimi €	Mbetja €
Renovimi i Gjykatës së GJKK-së	15556	102,872.00	78,357.97	24,514.03
Softuer	11135	0.00	0.00	0.00
Automjete	11136	35,000.00	34,880.00	120.00
Gjithsej:		137,872.00	113,237.97	24,634.03

Realizimi i buxhetit për shpenzime komunale

Realizimi i buxhetit në kategorinë të shpenzimet e komunaleve për vitin 2021 të ndara sipas muajve:¹

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	350.00	350.00	203.99	146.01
Shkurt	350.00	350.00	202.11	147.89
Mars	350.00	350.00	211.62	138.38
Prill	350.00	350.00	225.94	124.06
Maj	350.00	350.00	211.28	488.72
Qershor	350.00	350.00	216.42	133.58
Korrik	250.00	250.00	224.02	25.98
Gusht	250.00	250.00	218.12	31.88
Shtator	50.00	50.00	232.02	(182.02)
Tetor	0.00	0.00	214.10	(214.10)
Nëntor	0.00	0.00	204.48	(204.48)
Dhjetor	0.00	0.00	218.97	(218.97)
Gjithsej	2,650.00	2,650.00	2,583.07	66.93

¹ Shpenzimet e komunaleve nga Gjykata Kushtetuese janë bërë vetëm në kodin e telefonisë fikse, ndërsa shpenzimet e rrymës dhe mbeturinave i mbulon Ministria e Administratës Publike.

NJËSIA E PROKURIMIT

NJËSIA E PROKURIMIT

Në mbështetje të planit të prokurimit për vitin 2021, Njësia e Prokurimit ka iniciuar dhe zhvilluar gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) aktivitete të prokurimit, dhe janë nënshkruar njëzet e dy (22) kontrata, nga të cilat tri procedura kanë qenë të ndara në dy (2) lote.

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, aktivitetet e prokurimit janë klasifikuar sipas tipit, vlerës dhe procedurës, të paraqitura si në vijim:

a. Procedurë me vlerë minimale (deri në 1000 euro);

b. Procedurë e kuotimit të çmimeve (vlerë e vogël);

c. Procedurë e hapur (vlerë e mesme);

d. Procedure e hapur (vlerë e madhe).

a) Procedurë me vlerë minimale

Gjatë vitit 2021 janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsej nëntë (9) aktivitete dhe janë nënshkruar nëntë (9) kontrata, si në vijim:

1. Matja e objektit realizues bazuar në lejen e ndërtimit të objektit të Gjykatës;
2. Ndërrimi dhe montimi i gomave, balancimi dhe hotelimi (ruajtja) e gomave;
3. Kornizë për foto me argjend – elegante;
4. Shërbimet teknike të riparimit, mirëmbajtjes, ngjyrosjes dhe politurë të pesë (5) automjeteve;
5. Mirëmbajtja e klimatizmit;
6. Furnizim me inventar për zyrën e Kryetares;
7. Furnizim me foto qelinë për hapjen e dyerve të ashensorit;
8. Ndërrimi dhe montimi i gomave, balancimi dhe hotelimi (ruajtja) e gomave; dhe
9. Furnizim me goma dimri.

b) Procedurë e kuotimit të çmimeve (vlerë e vogël).

Gjatë vitit 2021 janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsej pesë (5) aktivitete dhe janë nënshkruar pesë (5) kontrata, si në vijim:

1. Shërbime për Strehimin (hostimin), Programimin dhe mirëmbajtjen e ueb-faqes së Gjykatës;
2. Mirëmbajtja dhe servisimi i gjeneratorit;
3. Mbikëqyrja e projektit për Renovimin e gjykatores dhe renovimin e hyrjes dhe korridoreve në objektin e Gjykatës;
4. Furnizim me aparate telefoni (smartphone); dhe
5. Sigurimi i veturave zyrtare TPL, TPL Plus dhe Full Kasko–EU, për 7 vetura.

c) Procedurë e hapur (vlerë e mesme)

Gjatë vitit 2021 janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsej dymbëdhjetë (12) aktivitete, një prej tyre e bartur nga viti 2020, dhe janë nënshkruar dymbëdhjetë (12) kontrata, si në vijim:

1. Shërbime të mirëmbajtjes dhe pastrimit të hapësirave dhe objekteve të Gjykatës;
2. Renovimi i gjykatores dhe renovimi i hyrjes dhe korridoreve në objektin e Gjykatës;
3. Furnizim me pajisje të TI-së, PC allinone, lloptopa dhe monitora;

4. Sigurimi i veturave zyrtare TPL, TPL Plus dhe Full Kasko–EU;
5. Shërbime të mirëmbajtjes dhe pastrimit të hapësirave dhe objekteve të Gjykatës (procedurë e negociuar);
6. Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Passat 2.0 TDI HIGHLINE (4 MOTION);
7. Sigurimi i veturave zyrtare TPL, TPL Plus dhe Full Kasko–EU për veturën SKODA Octavia Ambition 2.0 TDI DSG dhe Full Kasko–EU për veturën SKODA Octavia Ambition 1.6 TDI (procedurë e negociuar);
8. Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve të sistemit audio – video dhe përkthimit simultan;
9. Furnizim me automjet zyrtar;
10. Shërbime fotografimi, kornizimi dhe shërbime të xhirimit;
11. Mirëmbajtja dhe servisimi i ashensorit dhe furnizimi me pjesët rezervë; dhe
12. Furnizimi, shtypja e broshurave dhe materialeve tjera për shtypje.

d) Procedurë e hapur (vlerë e madhe)

Gjatë vitit 2021 nuk është iniciuar dhe zhvilluar ndonjë aktivitet i prokurimit me procedurë të hapur me vlerë të madhe.

Pasqyrimi në tabelë i të gjitha pagesave të realizuara gjatë vitit 2021 si dhe furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për kontratat e nënshkruara.

Pagesat e furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për kontratat e nënshkruara në vitin 2021	Shuma e përgjithshme e pagesave gjatë vitit 2021
Shuma e kontratave, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	187,178.35€
Shuma e paguar për kontrata	161,479.81€
Shuma e përgjithshme	348,658.16 €

NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE MULTIMEDIAVE

NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT KOMUNIKIMIT DHE MULTIMEDIEVE

Njësia e Teknologjisë së Informacionit, Komunikimit dhe Multimedias (në tekstin e mëtejshëm: Njësia TIK dhe Multimedias) është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve dhe përkujdesjen profesionale në infrastrukturën e përgjithshme të teknologjisë informative në Gjykatë Kushtetuese.

Gjatë viti 2021, Njësia TIK dhe Multimedias ka realizuar projektet dhe detyrat sipas planit dhe përgjegjësi të saj, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe profesional me pajisje të avancuara teknologjike, në përputhje me planin e punës dhe Planin Strategjik të Gjykatës.

Projektet e realizuara

- Duke u bazuar në gjendjen e krijuar në vend nga virusi Covid-19 edhe gjatë vitit 2021, Gjykata ka vazhduar që seancat shqyrtuese, administrative dhe takimet e ndryshme t'i mbajë përmes platformave online. Njësia e TIK dhe Multimedias ka marrë përgjegjësinë dhe është angazhuar që të ofrojë përkrahjen me platformën online Zoom, për të mundësuar realizimin e detyrave dhe përgjegjësi për stafin e Gjykatës. Për platformën Zoom është blerë dhe siguruar licenca me kanale të përkthimit për të siguruar përkthimin e gjuhëve përkatëse gjatë mbajtjes të seancave. Gjatë vitit 2021 janë mbajtur gjithsej 121 seanca dhe takime online;
- Është përfunduar konfigurimi i back-up serverit të ri, sipas planit për të instaluar në një lokacion tjetër jashtë objektit të Gjykatës;
- Janë instaluar dhe konfiguruar pajisjet e përkthimit në bashkëpunim me kompaninë kontraktuese për pajisjet specifike të incizimit dhe përkthimit në sallën e gjyqimit e cila gjatë kësaj periudhe ishte në renovim;
- Realizimi i projektit për e-librarinë (bibliotekës elektronike për regjistrimin e librave që posedon Gjykata) dhe makinën e kërkimit "search serverit" (platformës kërkimore, që do të mundëson kërkimin në të gjitha dokumentet e brendshme, vendimet e Gjykatës, aktet ligjore dhe nënligjore, platformën e librarisë të brendshme, dhe mundësinë e kërkimit në platformën e jashtme HUDOC), projekt i cili është financuar me donacion nga Këshilli i Evropës, i zhvilluar dhe instaluar në serverët e Gjykatës;
- Projekti për zhvillimin dhe avancimin e sistemit të CDMS-it, projekt i cili është financuar nga Këshilli i Evropës i përgatitur dhe specifikuar nga grupi punues i Gjykatës Kushtetuese për qëllim të avancimit dhe automatizimit në menaxhimin e rasteve që regjistrohen në Gjykatë, projekt i cili është në fazën e migrimit të të dhënave dhe testimit;
- Është përfunduar versioni i parë i ndryshimeve në ueb-faqe për avancimin e filtrimit të vendimeve dhe aktvendimeve, sipas kërkesës së parashtruar për krijimin e një kategorie të re të vendimeve dhe regjistrimin e neneve për Aktvendime; dhe
- Janë realizuar furnizimet me pajisje të TI-së sipas planit të paraparë. Është përfunduar procesi i furnizimit me pajisje të TI-së, PC-all-in-one (10 copë), Laptop (20 copë) dhe Monitorë (3 copë), ku të gjithë zyrtarëve u janë zëvendësuar pajisjet (kompjuterët) e vjetër me të ri, duke i instaluar dhe konfiguruar sipas planit.

Aktivitetet e ndërmarra

- Përkujdesja dhe ofrimi i shërbimeve për mbarëvajtjen e sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë dhe komunikimit për të gjithë të punësuarit në Gjykatë, kemi intervenuar edhe përmes distancës në ofrimin e shërbimeve të TI-së për mbajtjen e seancave online;
- Menaxhimi dhe organizimi i detyrave teknike dhe operative brenda Njesisë së TIK dhe Multimedias duke ofruar përkrahjen e nevojshme për funksionalizimin sa më të mirë të pajisjeve të teknologjisë informative dhe sistemeve brenda Gjykatës;
- Konfigurimi dhe instalimi i konzolës të Antivirusit (Sophos) në serverët e Gjykatës dhe aplikimi i përditësimeve të reja të Microsoft-it për të gjithë kompjuterët;
- Gjatë vitit 2021 janë kërkuar për t'u iniciuar gjithsej pesë (5) procese të prokurimit për blerjen e pajisjeve të ndryshme të TI-së, mirëmbajtje, softuer dhe pjesë përcjellëse sipas planit të paraparë për këtë vit;
- Kontrollimi dhe mirëmbajtja e sistemit të domenit të Gjykatës dhe krijimi i politikave të sigurisë në serverët e Gjykatës;
- Monitorimi dhe kontrollimi i sigurisë së rrjetës brenda Gjykatës dhe përditësimi i versioneve të reja (update) për të gjitha pajisjet duke i aprovuar dhe instaluar nga administratori i sistemit;
- Montimi, instalimi dhe konfigurimi i kompjuterëve të ri dhe regjistrimi në domenin e Gjykatës, si dhe transferimi i të dhënave duke i mirëmbajtur pajisjet e brendshme në ngritjen e sistemeve operative në Windows 10 dhe softuerët tjerë aplikativ;
- Gjatë vitit 2021 janë publikuar 254 vendime në ueb-faqen e Gjykatës në gjuhët që janë dërguar dhe kategorizimi i tyre në bazë listës së filtrimit; dhe
- Krijimi i kopjeve (back-up) të rregullta për sistemet dhe data-bazën e CDMS-it, përkujdesja dhe eliminimi i gabimeve, si dhe sigurimi në ruajtjen e të dhënave në dy kopjet e serverëve.

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Bazuar në planin vjetor për vitin 2021, Njësia e Auditimit të Brendshëm (në tekstin e mëtejshëm: NJAB) ka përfunduar me kohë të gjitha auditimet e planifikuara, si në vijim:

1. Komunikimi dhe informimi brenda dhe jashtë Gjykatës në ZKI;
2. Menaxhimi i përkthimeve dhe funksionimi i kontrollit të brendshëm në DPP;
3. Menaxhimi i shpenzimeve; dhe
4. Menaxhimi i prokurimit.

Gjithashtu, NJAB ka hartuar dhe ka dorëzuar brenda afatit të caktuar:

- Planin Strategjik të Auditorit të Brendshëm për periudhën 2022-2024, dhe
- Planin Vjetor të Auditorit të Brendshëm për vitin 2022.

Përveç auditimeve të planifikuara, në tremujorin e fundit kemi startuar edhe me një auditim me kërkesë nga menaxhmenti i Gjykatës.

Të gjitha auditimet e brendshme janë zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me qëllim të realizimit të objektivave të institucionit dhe të NJAB që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe me përmirësimin e efikasitetit në punë, me shmangien e gabimeve të mundshme, me rritjen e vlerës dhe me raportimin e parregullsive dhe gabimeve me qëllim të shtimit të kontrollit që të ofrohet siguri tek menaxhmenti i Gjykatës për funksionimin efikas në departamentet përkatëse.

Në vazhdimësi janë bërë vizita përcjellëse për efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të funksionimit të kontrollit të brendshëm si dhe të zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i Brendshëm dhe nga Auditori i Përgjithshëm.

Menaxhmenti ka vlerësuar punën e auditorëve dhe në rastin e parë të mundshëm është kujdesur për implementimin e rekomandimeve të dhëna si nga auditori i brendshëm, gjithashtu edhe nga auditorët e përgjithshëm, e kjo ka ndikuar në ngritjen e cilësisë së aktiviteteve dhe performancës së Gjykatës.

Gjithashtu, NJAB ka realizuar Planin vjetor të Auditorit të Brendshëm për vitin 2022.

1. Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur këshillëdhënës në Gjykatën Kushtetuese i cili funksionon bazuar në:

- Udhëzimin Administrativ për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektet e Sektorit Publik;
- Statutin e KAB;
- Praktikat e mira; dhe
- Standardet ndërkombëtare të auditimit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm siguron mbikëqyrje të planeve, raporteve dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna nga auditorët, si dhe gjatë vitit 2021 ka mbajtur katër (4) takime.

ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM

ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM

Zyra për Komunikim dhe Informim (në tekstin e mëtejshëm: ZKI) në fushën e përgjegjësisë të saj përfshin: (i) informimin dhe komunikimin me mediat/publikun, (ii) monitorimin e mediave, (iii) publikimin e njoftimeve në ueb-faqen e Gjykatës përkitazi me vizitat/aktivitetet dhe seancat/vendimet, (iv) publikimin e Buletinit Informativ të Gjykatës, (v) publikimin e Librit të Gjykatës dhe të fletushkave/broshurave të tjera informative, (vi) komunikimin me palët/qytetarët, (vii) protokollin, (viii) kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe (ix) bashkëpunimin me Komisionin e Venecias.

Gjatë vitit 2021, në ZKI janë kryer këto aktivitete:

I. Monitorimi i mediave:

- Janë përpiluar 144 raporte ditore të mediave;
- Janë përpiluar 48 raporte javore të mediave; dhe
- Është bërë arkivimi fizik dhe elektronik i raporteve të mediave të shtypura (112 artikuj) dhe të mediave elektronike (725 artikuj) përkitazi me punën e Gjykatës.

II. Komunikimi me mediat/publikun:

- Janë dërguar përgjigjet në 135 pyetje të parashtruara nga mediat e shkruara dhe ato elektronike, si dhe në 361 pyetje/kërkesa të parashtruara nga qytetarët dhe institucionet;
- Janë publikuar 33 njoftime përkitazi me vizitat dhe aktivitetet e Gjykatës;
- Janë publikuar 12 njoftime me informata statistikore përkitazi me seancat dhe vendimet e publikuara të Gjykatës; dhe
- Janë publikuar 29 njoftime me informata përmbledhëse përkitazi me vendimet e Gjykatës.

III. Publikimi i fletushkave/broshurave dhe i materialeve të tjera informative:

- Është publikuar Raporti vjetor i mediave për vitin 2021;
- Është publikuar numri i 11-të dhe i 12-të i Buletinit Informativ të Gjykatës; dhe
- Është publikuar Buletini i Praktikës Gjyqësore për vitin 2020.

IV. Aktivitetet protokollare:

- Janë kryer detyrat protokollare përkitazi me 26 vizita zyrtare në Gjykatë, 3 vizita zyrtare në institucionet vendore, 3 vizita zyrtare jashtë vendit, 2 punëtori/konferenca të organizuara në vend, 2 punëtori/konferenca të organizuara jashtë vendit dhe 15 punëtori/konferenca të organizuara nëpërmjet video-konferencës; dhe
- Janë përgatitur 206 letër-këmbime me udhëheqës institucional vendor e ndërkombëtar.

V. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare:

- Gjatë vitit 2021 janë pranuar gjithsej 21 kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës, ku të gjitha kërkesat janë aprovuar nga Gjykata;
- Janë përgatitur 4 raporte tremujore përkitazi me kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës; dhe
- Është përgatitur Raporti vjetor për kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës për vitin 2020.

VI. Komunikimi me palët/qytetarët:

Gjatë vitit 2021, në recepsionin e Gjykatës janë regjistruar dhe proceduar:

- 343 qytetarë; dhe
- 88 përfaqësues institucionesh.

VII. Bashkëpunimi me Komisionin e Venecias:

- Janë dërguar përgjigjet e Gjykatës në 62 pyetje të parashtruara nëpërmjet Forumit të Komisionit të Venecias nga 12 gjykata kushtetuese dhe supreme të shteteve anëtare (*me gjithsej 19 kërkesa*); dhe
- Janë dorëzuar 3 raporte katërmujore, së bashku me vendimet më të rëndësishme të Gjykatës për publikim në Buletinet e Komisionit të Venecias.

AKTIVITETET TJERA TË GJYKATËS KUSHTETUESE

AKTIVITETET TJERA TË GJYKATËS KUSHTETUESE

I. Udhëtimet zyrtare

28 - 30 shtator 2021

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, i udhëhequr nga Kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, realizuan një vizitë zyrtare në Shqipëri.

Gjatë qëndrimit në Tiranë, kryetarja Caka – Nimani dhe homologia e saj shqiptare, znj. Vitore Tusha, nënshkruan në një ceremoni solemne Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, me qëllim të vazhdimit të bashkëpunimit të dy gjykatave për një periudhë të re pesëvjeçare, në fushat me interes të ndërsjellë.

Memorandumi i Bashkëpunimit, ndër të tjera, parasheh zhvillimin e programeve të bashkëpunimit dypalësh me qëllim të përvetësimit të praktikave më të mira evropiane të së drejtës kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, forcimin e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe të stafit mbështetës, rritjen e cilësisë së vendimeve dhe përmirësimin e komunikimit me publikun.

Gjithashtu, me përkrahjen e fondacionit gjerman “Hans Siedel Stiftung”, në vazhdim të vizitës në Shqipëri, gjyqtarët e të dy gjykatave kushtetuese morën pjesë në tryezën e rrumbullakët me temë: *“Mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore – praktikat respektive sipas jurisprudencës kushtetuese”*.

14 - 19 nëntor 2021

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare disaditëshe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (në tekstin e mëtejshëm: SHBA).

Kryetarja Caka – Nimani u takua në Uashington me, ndër të tjerë, zv. ndihmës Prokurorin e Përgjithshëm të SHBA-ve dhe Këshilltarin për çështje ndërkombëtare në Departamentin e Drejtësisë, z. Bruce C. Swartz.

Pasi që i shprehu falënderimin për ndihmën e vazhdueshme që SHBA-të i kanë ofruar Kosovës dhe zhvillimit institucional të saj ndër vite, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit, Kryetarja Caka – Nimani e njoftoi z. Swartz përkitazi me të arriturat dhe sfidat në gjyqësinë kushtetuese. Të dyja palët në vazhdim shkëmbyen pikëpamjet e tyre lidhur me mekanizmat më efektiv për forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës dhe rëndësinë e konsolidimit të sundimit të së drejtës në çdo vend demokratik.

Gjatë qëndrimit në Uashington, Kryetarja Caka – Nimani u takua edhe me zyrtarë të lartë në Departamentin e Shtetit dhe Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), si dhe me përfaqësues të SHBA-ve në Komisionin e Venecias.

Vizitën e saj në SHBA, Kryetarja Caka-Nimani e filloi me pjesëmarrjen në Konferencën Ndërkombëtare me temë: “Të drejtat e patjetërsueshme dhe traditat e konstitucionalizmit”, organizuar nga Instituti Kellog për Studime Ndërkombëtare në Universitetin Notre Dame, në të cilën pjesëmarrës ishin gjyqtarë e kryetarë të gjykatave kushtetuese dhe supreme të shteteve anembanë botës, si dhe akademikë dhe ekspertë të shquar ndërkombëtarë në fushën e të

drejtave të njeriut. Duke qenë njëra nga panelistet kryesore në konferencë, kryetarja Caka – Nimani bëri një prezantim të detajuar përkitazi me traditën kushtetuese të Kosovës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në përputhje me parimet e mishëruara në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Me ftesë të Fakultetit Juridik në kuadër të Universitetit Notre Dame, Kryetarja Caka – Nimani gjithashtu mbajti edhe ligjëratë mbi historikun dhe traditën kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

7 dhjetor 2021

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, i udhëhequr nga Kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi në Shkup për vizitë zyrtare në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut.

Gjatë qëndrimit në kryeqytetin maqedonas, kryetarja Caka – Nimani dhe homologia e saj, znj. Dobrila Kacarska, diskutuan bashkërisht me gjyqtarët e të dy gjykatave mbi modalitetet e intensifikimit të mëtutjeshëm të bashkëpunimit institucional në fushat me interes të ndërsjellë.

Të dyja palët u dakorduan për hapat e radhës që duhet ndërmarrë në drejtim të thellimit të bashkëpunimit, me fokus të veçantë në shkëmbimin e përvojave drejt avancimit të praktikave përkatëse gjyqësore.

Në vijim të vizitës, gjyqtarët e të dy gjykatave morën pjesë në punëtorinë e përbashkët të organizuar përkitazi me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut, me referencë të veçantë në zbatimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II. Vizitat zyrtare në Gjykatën Kushtetuese/Aktivitete të tjera

4 shkurt 2021

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe kryesuesit e grupeve punuese të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese (2018 – 2020) mbajtën punëtorinë përmbyllëse për zbatimin e Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese.

9 shkurt 2021

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe kryesuesit e grupeve punuese të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese, zhvilluan takime konsultative nëpërmjet video-konferencës me ekspertë të angazhuar nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë përkitazi me hartimin e qëllimeve strategjike dhe objektivave të Planit të ri Strategjik të Gjykatës Kushtetuese (2021 – 2025).

11 shkurt 2021

Në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, “Përmirësimi i Mbrojtjes së Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Kushtetuese”, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, këshilltarja e parë, juriskonsulti, dy zëvendës-këshilltarët e parë, drejtori i Zyrës për Komunikim dhe Informim dhe kryesuesi i Njesisë së TIK dhe Multimedias, diskutuan nëpërmjet video-konferencës me përfaqësues të Këshillit të Evropës

përkitazi me aktivitetet e deritanishme të Gjykatës, të financuara nga Zyra e KE-së në Prishtinë, dhe për projektet e radhës që do të mund të financoheshin nga KE.

19 shkurt 2021

Në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, “Përmirësimi i Mbrojtjes së Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Kushtetuese”, këshilltarët e Gjykatës morën pjesë në punëtorinë e organizuar nëpërmjet video-konferencës në temën: “Të Drejtat e Pronës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

28 maj 2021

Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i prirë nga kryetarja e kësaj gjykate, znj. Vitore Tusha, qëndroi për vizitë zyrtare në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Delegacioni nga Shqipëria u prit në takim nga Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Arta Rama – Hajrizi dhe gjyqtarët e tjerë të Gjykatës, ku temë qendrore e diskutimit ishin funksionimi i të dy gjykatave në kushte pandemie, praktikat dhe metodat e punës në procedimin e lëndëve, vendimmarrja në distancë, si dhe konsolidimi i jurisprudencës të të dy gjykatave në harmoni me standardet ndërkombëtare të drejtësisë kushtetuese.

21 qershor 2021

Në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, “Përmirësimi i Mbrojtjes së Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Kushtetuese”, është mbajtur punëtoria e organizuar nëpërmjet video-konferencës mbi: “Sistemet e Menaxhimit të Lëndëve në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në Gjykatën Kushtetuese”.

25 qershor 2021

Me një ceremoni zyrtare është bërë pranim-dorëzimi solemn i detyrës së Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ndërmjet kryetares së deriatëhershme, znj. Arta Rama – Hajrizi dhe kryetares së zgjedhur, znj. Gresa Caka – Nimani, më 25 qershor 2021, në Gjykatën Kushtetuese.

3 - 4 shtator 2021

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, z. Safet Hoxha dhe z. Nexhmi Rexhepi morën pjesë në Forumin e Tetë Rajonal për Sundimin e Ligjit për Evropën Juglindore me temë: “Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit, parime këto që mbrohen nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe e Drejta e Bashkimit Evropian”, organizuar nga “Qendra AIRE” dhe organizata “Civil Rights Defenders”, me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, të Qeverisë së Suedisë dhe të Fondacionit gjerman “Konrad Adenauer”, mbajtur më 3 dhe 4 shtator 2021, në Prishtinë.

7 - 8 shtator 2021

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Turqisë, këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Nexhat Kelmendi dhe z. Kreshnik Jonuzi përmes video-konferencës morën pjesë në programin “Shkolla e 9-të Verore” mbi temën “Problemet aktuale në zbatimin e aktgjykimeve: Drejtësia Kushtetuese”, mbajtur më 7 dhe 8 shtator 2021.

SHTOJCA I

SHTOJCA I

Përmbledhje e llogarive të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2021
Pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme

Shënim	2021			2020			2019		
	Llogaria e vetme e Thesarit			Llogaria e vetme e Thesarit			Llogaria e vetme e Thesarit		
	BKK €	THV €	Pagesat nga palët e treta të jashtme €	BKK €	THV €	Pagesat nga palët e treta të jashtme €	BKK €	THV €	Pagesat nga palët e treta të jashtme €
Pranimet									
Ndarjet nga Fondi i përgjithshëm	1,958,128.31			1,886,805.33			1,957,335.82		
Të hyrat vetanake									
Ndarjet nga Fondi me qëllime të dedikuara									
Grantet e përcaktuara të donatorëve									
Fondi i huazimeve									
Pranimet e tjera									
Totali i pranimeve	1,958,128.31	-		1,886,805.33	-	-	1,957,335.82	-	-
Pagesat									
Operacionet									
Pagat dhe mëditjet	2	1,290,201.18		1,290,540.94			1,288,021.58		
Mallrat dhe shërbimet	3	546,106.09		378,504.67			420,473.40		
Shërbimet komunale	4	2,583.07		2,463.72			2,652.28		
		1844,809.34		1,671,509.33			1,711,147.26		
Transferet									
Transferet dhe subvencionet	5								
Shpenzimet kapitale									
Prona, ndërtesa dhe pajisjet	6								
Kthimi Huamarrjes	7	113,237.97		215,296.00			246,188.56		
Pagesat e tjera	8								
Pagesat gjithsej	1,958,128.31	-		1,886,805.33		-	1,957,335.82		-

Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit

Shënime		2021				2020	2019
		Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Dallimi	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=C-B	E	F
		€	€	€	€	€	€
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Të hyrat tatimore	9						
Të hyrat jo tatimore	10						
Të hyrat dedikuara	11						
Grantet dhe ndihma	12						
Huamarrje	13						
Tjera	14						
Pranimet totale të mbledhura për BKK			-	-	-	-	-
Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit							
Pagat dhe mëditjet	2	1,178,098	1,296,201	1,296,201	0	1,290,541	1,288,022
Mallrat dhe shërbimet	3	457,317	546,167	546,106	61	378,505	420,473
Shërbimet komunale	4	4,000	2,650	2,583	67	2,464	2,652
Transferet dhe subvencionet	5						
Shpenzimet kapitale	6	225,372	137,872	113,238	24,634	215,296	246,189
Fondi i privatizimit	7						
Të tjera	8						
Totali i pagesave të bërë nga BKK		1,864,787	1,982,890	1,958,128	24,762	1,886,805	1,957,336

Ndarjet e fondit të përgjithshëm për vitin 2021

Klasifikimi ekonomik	2021			2020	2019
	BKK	THV	Totali		
	€	€	€	€	€
Pagat dhe mëditjet	1,296,201		1,296,201	1,290,541	1,288,022
Mallrat dhe shërbimet	546,106		546,106	378,505	420,473
Shërbimet komunale	2,583		2,583	2,464	2,652
Subvencionet dhe transferet					
Shpenzimet kapitale	113,238		113,238	215,296	246,189
	1,958,128	-	1,958,128	1,886,805	1,957,336

ORGANOGRAMMI



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

